



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:182193

Datë: 17.09.2024

Numri i dokumentit: 06168178

CN.nr.31 /2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtarin Baki Shigjeqi dhe bashkëpunëtoren profesionale Hyra Duraj, në çështjen jokontestimore të propozuesit F.H. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson S.R. avokat nga Prizreni, të paraqitur ndaj kundërpropozuesit Komuna e Prizrenit, për shkak të kompensimit të paluajtshmërisë së shpronësuar, jashtë seance, me datë 17.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. PEZULLOHET procedura në çështjen juridike jokontestimore, me numër CN.nr.31/2021.

II. Pasi që ky aktvendim të marrë formën e prerë, procedura jo kontestimore në këtë çështje juridike, do të vazhdon së zhvilluari sipas rregullave të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren, ka në procedim e sipër procedurën jo kontestimore në çështjen juridike jo kontestimore, sipas propozimit të propozuesit F.H. nga Prizreni, të parashtruar ndaj kundër propozuesit Komuna e Prizrenit, për çështjen kompensimin e paluajtshmërisë së shpronësuar.

Propozuesi fillimisht ka paraqitur padi për vërtetimin e pronësisë, ndërsa gjykata me datë 30.10.2020, ka marrë aktvendim me shenjën C.nr.345/19 dhe është përfunduar procedura kontestimore dhe pas plotfuqishmërisë së aktvendimit, procedura ka vazhduar në të njëjtën gjykatë sipas rregullave të procedurës jokontestimore dhe ka marrë shenjën CN.nr.31/2021.

Për shkak të zhvillimit të procedurës në këtë çështje juridike jokontestimore gjykata ka caktuar seancën gjyqësore me datë 05.08.2024, në të cilën i autorizuari i propozuesit ka deklaruar se pasi që nuk ka aktvendim për eksproprijim nga organi kompetent, rruga në vendin e ngjarjes është ndërtuar nga Komuna e Prizrenit dhe shfrytëzohet pa pëlqim nga pronari dhe në interes publik nga qytetarët tjerë, pa plan detal, ashtu që duke u bazuar dhe në praktikën dhe vërejtjet e

Gjykatës së Apelit me shenjën AC.nr.7513/22, të datës 29.01.2024, ku ka cekur se në rast shpronësimit faktik të pronës, procedura duhet të vazhdoj në procedurë kontestimore, gjykatës i ka propozuar që çështja nga procedura jokontestimore të kaloj në procedurë kontestimore.

Përfaqësuesja e kundërpropozueses Komuna e Prizrenit, me parashtresën e datës 22.08.2024, gjykatës ia ka përcjellë përgjigjen e Sektorit për Çështje Pronësore Juridike pranë Komunës së Prizrenit, ku të njëjtit kanë theksuar se Komuna e Prizrenit asnjëherë nuk ka zhvilluar procedurën administrative për shpronësimin e ngastrave kadastrale me numër 5012-1, 5012-2 dhe 5012-10 ZK Prizren.

Bazuar në të lartcekurat dhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate, për propozimin e propozuesit, nuk mund të vendoset në procedurën jo kontestimore por duhet të vendoset në procedurën kontestimore, e përkritazi me çështjen e zbatimit të dispozitave të procedurës kontestimore në procedurën jo kontestimore, e për këtë bëhet fjalë në nenin 3 të Ligjit të Procedurës Jo Kontestimore (LPJK) në të cilin, thuhet se *“Në procedurën jokontestimore përshtatshëmrisht zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurën kontestimore, po qe se me këtë ligj nuk është paraparë ndryshe”*, kurse për çështjen e kompetencës së gjykatës, bëhet fjalë në nenin 17 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e cila përcakton se *“Gjykata sipas detyrës zyrtare, menjëherë pas marrjes së padisë, duhet të konstatojë se a është kompetente për procedimin e çështjes që i është paraqitur. Ky vlerësim i kompetencës bëhet në bazë të thënieve në padi dhe në bazë të fakteve që i ka të njohura vetë gjykata ...”* derisa në nenin 19 të LPK-së, që flet për kujdesin sipas detyrës zyrtare të gjykatës për kompetencën lëndore, e në të cilin thuhet se: *“Secila gjykatë gjatë gjithë procedurës së shkallës së parë, sipas detyrës zyrtare kujdeset për kompetencën e vet lëndore”*, ndërsa për pezullimin e procedurës jo kontestimore në një çështje juridike jo kontestimore, në nenin 16 të LPJK-së, parashihet se: *“Në qoftë se gjykata gjatë zhvillimit të procedurës jo kontestimore konstaton se procedura duhet të zhvillohet sipas rregullave të procedurës kontestimore, ajo duhet të vendosë pezullimin e procedurës me anë të aktvendimit. Pasi të bëhet i formës së prerë aktvendimi nga paragrafi 1 i këtij neni procedura e mëtejme vazhdon së zhvilluari sipas rregullave të procedurës kontestimore në gjykatën kompetente”*, derisa për formën e vendimeve në procedurën jo kontestimore, bëhet fjalë në nenin 17 të LPJK-së, e në të cilin, thuhet se *“Në procedurën jokontestimore vendimet jepen në formë të aktvendimeve”*.

Duke qenë se në rastin konkret kundërpropozuesi Komuna e Prizrenit, nuk e ka nxjerrë Vendimin Përfundimtar për Shpronësimin, me të cilin është miratuar apo refuzuar kërkesa për kompensimin e paluajtshmërisë, kompensimin e të cilës e kërkon këtu propozuesi F.H. nga Prizreni, gjykata vlerëson se çështja juridike për kompensimin e paluajtshmërisë duhet të zhvillohet sipas rregullave të procedurës kontestimore. Përkatesisht nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga përgjigjja e datës 15.08.2024, e dhënë nga Sektori për Çështje Pronësore Juridike pranë Komunës së Prizrenit, rezulton se kundërpropozuesja Komuna e Prizrenit asnjëherë nuk ka zhvilluar procedurën administrative për shpronësimin e ngastrave për të cilat kërkohet kompensimi i tyre, e që nënkupton se kemi të bëjmë me shpronësim faktik (pa

procedurë të shpronësimit) dhe se kjo çështje juridike duhet të zhvillohet në procedurën kontestimore.

Prandaj, nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi dhe në kuptim të nenit 3, 16, dhe nenit 17 të Ligjit të Procedurës Jo Kontestimore (LPJK) lidhur me nenin 17, dhe 19 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK).

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHME - DIVIZIONI CIVIL
2022:182193, 17.09.2024

G j y q t a r i

Baki Shigjeqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë të paraqes ankese në afatin prej 15 ditëve, pas ditës së pranimin të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.